

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 paragrafi (10) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 124 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15 dhe 65/18), duke vepruar sipas propozimit për shpalljen e një vendimi të pavlefshëm, dorëzuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial, në seancën e mbajtur më 15.07.2024, miratoi

AKTVENDIM

1. Propozimi Pa.nr.10-93 i datës 20.06.2024 (nr. 13-801/2 i datës 19.06.2024) i Drejtorisë për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial për shpalljen e pavlefshme të Aktvendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa.nr.10-135 të datës 08.11.2023, PRANOHET.
2. Vendimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa. nr. 10-135 i datës 08.11.2023, SHPALLET I PAVLEFSHËM PASI EKZEKUTIMI I TIJ NUK ËSHTË I MUNDUR.

ARSYETIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KMK) me shkresën nr.10-93 të datës 31.05.2024 kërkoi nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial (DZZHTI) të prononcohej zyrtarisht në lidhje me informacionet në media se "Marrëveshja për ndarjen e ndihmës shtetërore për Kompaninë për Prodhime, Tregti dhe Shërbime NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë po ndërpritet për shkak të paaftësisë paguese të kompanisë "mëmë", si dhe çdo procedurë e parashikuar për ndarjen e fondeve publike". Duke marrë parasysh sa më sipër, KMK kërkoi nga DZZHTI -ja të deklaronte nëse ndihma shtetërore e planifikuar për trajnim të specializuar për Kompaninë për Prodhime, Tregti dhe Shërbime NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë mund të realizohej apo jo.

DZZHTI -ja, më datë 19.06.2024, dorëzoi shkresën nr.13-801/2 (nr. ynë 10-93 i datës 20.06.2024) me një propozim drejtuar KMK-së për shpalljen e pavlefshme të Aktvendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa.nr. 10-135 të datës 08.11.2023.

DZZHTI -ja, me shkresën nr. 13-801/2 të datës 19.06.2024, informoi KMK-në dhe konfirmoi se pas informacioneve të marra për paaftësinë paguese të kompanisë "mëmë", e cila është themeluesja/pronarja sipas të dhënave nga Regjistri Qendror, investimi i planifikuar i NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë për prodhimin e automjeteve po ndërpritet dhe nuk do të realizohet.

Gjithashtu, në shkresën e DZZHTI -së theksohet se nuk ekziston mundësia për ekzekutimin e Aktvendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa.nr.10-135 të datës 08.11.2023.

Pas shqyrtimit të propozimit të DZZHTI -së për shpalljen e Aktvendimit të KMK-së Pa. nr. 10-135 të datës 08.11.2023 të pavlefshëm, KMK konstatoi se:

KMK me Aktvendimin nr. 10-135 të datës 08.11.2023 konstatoi se ndihma e planifikuar për trajnim të specializuar të punonjësve në masën 25% të shpenzimeve të justifikuara të realizuara deri në datën e përfundimit drejt Kompanisë për Prodhime, Tregti dhe Shërbime NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë përbën ndihmë shtetërore dhe e njëjta është e lejuar

si ndihmë individuale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, si ndihmë horizontale për trajnim të specializuar sipas nenit 4 paragrafi (1) pika 14 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Në propozimin e DZZHTI -së nr. 13-801/2 të datës 19.06.2024 është theksuar se ndihma shtetërore e planifikuar për trajnim të specializuar për punonjësit në Kompaninë për Prodhime, Tregti dhe Shërbime NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë nuk do të ndahet për shkak të mosrealizimit të projektit investues, gjegjësisht për shkak të paaftësisë paguese të kompanisë "mëmë". Prandaj, investimi i planifikuar ndërpritet dhe nuk do të realizohet.

KMK e pranon këtë si arsye për të cilën Aktvendimi i KMK-së Pa. nr. 10-135 i datës 08.11.2023 nuk mund të ekzekutohet fare dhe të njëjtin e shpall TË PAVLEFSHËM.

Në bazë të sipërpërmendurës KMK vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e një kontesti administrativ para gjykatës kompetente brenda afatit prej 30 ditësh nga data e dorëzimit të tij. Padia nuk e shtyn ekzekutimin e Aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска